



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
SKUPŠTINA OPŠTINE DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

SEKTORI PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE BARAZI GJINORE

RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2024



Për:	KRYETARIN E KOMUNËS SË GJAKOVËS – Z.ARDIAN GJINI
Nga:	UDHËHEQËSE E SEKTORIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT – BARAZI GJINORE- ZNJ .LUMNIJE SHLLAKU
Lënda:	RAPORT PUNE PËR PERIUDHËN JANAR- DHJETOR 2024
Data	05.02.2025

Me Udhëzimin Administrativ –MAPL – Nr. 208/02 për themelimin e Njësive për të Drejtat e Njeriut në Komuna, edhe me Statutin Komunal është paraparë themelimi i NJDNJ, si mekanizëm i qëndrueshëm dhe përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin komunal, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe politikat e institucioneve të Kosovës. Kjo zyrë, si pjesë e institucionit komunal si fushëveprim të vet ka promovimin e plotë të drejtave të njeriut, barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të komuniteteve

Aktivitetet e Zyrtares për Barazi Gjinore dhe Mundësi të Barabarta gjatë periudhës Janar-qershor janë të shumta:

Në këtë kuadër, kjo zyrë merret me aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe përkrahjen e të drejtave të grave, fëmijëve dhe dhunën në baza gjinore, në përkrahjen e projekteve të OJQ-ve në promovimin e barazisë gjinore, aktivitetet e grumbullimit të dhënave bazuar në moshë, gjini dhe etni të grupeve (komuniteteve), rastet e dhunës në familje, bashkërendimin e punëve dhe bashkëpunimin e mirëfilltë me të gjitha drejtoritë që prekin në fushën e barazisë gjinore, këshillimin për rastet e grave të ndara nga bashkëshortët, lidhur me përfitimin e ndihmave sociale, krijimin e partneritetit me subjektet relevante në komunë ,etj.

Zyrtarja per Barazi Gjinore në Komunën e Gjakovës konform përgjegjësive që ka shfrytëzon të gjithë mekanizmat e mundshëm për të krijuar mundësi për pjesëmarrje aktive të femrave dhe meshkujve në të gjitha fushat e jetës shoqërore, duke u munduar te krijoj nje klimë në të cilën atyre ju mundëson të japin kontributin e tyre në të gjitha sferat e jetës shoqërore.

Aktivitetet e sektorit per te drejtat e njeriut barazi gjinore.

Organiimi I nje punetorie ne bashkepunim me Rrjetin e Grave te Kosoves me anëtarët e MKDHF me daten 19 janar 2024 me temen: Zbatimi I Portokollit Shteteror te Trajtimitt të rasteve te Dhunës Seksuale.Qëlimi I ketij trajnimi ka qenë që anëtarët e MKDHF te trajnohen me qëllimin e këtij portokolli reagim shumë-sektorial në menaxhimin e rasteve te dhunës seksuale , hapat që duhen të ndërmiren për menaxhimin e rasteve te dhunës

seksuale , roli dhe përgjegjësit e secilit institucion. Trajnuese në punëtori ka qenë Monika Kozaqi.

Në kuadër të muajit mars muaj i promovimit të drejtave të grave janë zhvilluar këto aktivitete..

Muaji “ Mars” njihet si muaji i promovimit të drejtave të grave dhe barazisë gjinore prandaj gjatë këtyre ditëve organizohen aktivitete të ndryshme në mbarë botën. Edhe Komuna jonë, konkretisht njësia për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore ka organizuar aktivitete të ndryshme në kuadër të Muajit Mars – Muajit të promovimit të drejtave të grave. Bazuar në planin e aktiviteteve të shënuara në muajin e gruas, Komuna e Gjakovës ka realizuar aktivitetin përkatësisht tryezën e përbashkët të diskutimit me temën “Thyerja e stereotipive gjinore”. Kjo tryezë diskutimi ka synuar të adresojë dhe sfidoj stereotipat gjinore që vazhdojnë të ndikojnë në mënyrën se si shoqëria percepton rolet e grave dhe burrave në familje, arsim, tregun e punës, akademisë dhe komunitetit. Kjo tryeze ka pasur për qëllim të shërbejë si një platforme për shkëmbim përvojash, ideve dhe praktikave të mira në promovimin e barazisë gjinore. Pjesëmarrëse të diskutimit gjatë tryezës ishin gra dhe vajza të profileve të ndryshëm që shpalosen përvojat e tyre lidhur me sfidat dhe të arriturat në nivel të vendimmarrjes, fuqizimit ekonomik të gruas dhe përballimi dhe luftimi i stereotipive gjinore.

Organizimi i Fushatës një mujore mbi edukimin shëndetësor riprodhues të grave, nëpër të gjitha qendrat e Mjekësisë Familjare.

Me qëllim të vetedijesimit të grave për rëndësinë e vizitave dhe kontrollit tyre në parandalimin e sëmundjeve kancerogjene, si dhe arritja me e lartë e njohurive për evidetimin e sëmundjeve të gjirit dhe bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse. Përfutuese direkte nga ky aktivitet kanë qenë 200 gra (10 qendra nga 20 gra).

Aktivitete veteëdijësuese për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian me theks të veçantë të shëndetit riprodhues. Pjesëmarrës ishin mbi 20 gra dhe vajzat të komuniteteve.

Realizimi i hulumtimeve periodike për përfaqësimin e grave në institucionet publike dhe përfaqësimin e grave në pozitë vendimmarrëse në sektorin publik.

Në bazë të shënimeve që posedon zyra e personelit në vendet udhëheqëse në institucionet komunale të arsimit, shëndetësisë, kulturës dhe sportit, gjithsej janë 145 zyrtar, 41 femra dhe 104 meshkuj .Numri i përgjithshëm i të punësuarve në institucionet komunale është gjithsej 2479 të punësuar ,ku prej tyre janë 1477 femra dhe 1002 meshkuj. Numri i përgjithshëm i të punësuarave me nevojë të veçanta të punësuarve në të gjitha institucionet komunale janë 12, femra 4 dhe 8 meshkuj.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve nga komuniteti jo shumicë është 98 ku prej tyre 13 femra dhe 85 meshkuj.

Organizimi i një punëtorie me zyrtaret e informimit ne kuadër te projektit “ Parandalimi i dhunës ne baza gjinore” përmes edukimit dhe ndërgjegjësimit. Qëllimi i punëtorisë ishte trajtimi i masave parandaluese te dhunës ne familje, ne fokus te veçantë te raportimi te ndjeshëm gjinor ne media.

Organizimi i një punëtorie një ditore me qëllim të ngritjes se njohurive për 25 mësimdhënësve të edukatës qytetare dhe psikolog të shkollave fillore dhe të mesme të komunës se Gjakovës, mbi konceptin e dhunës ne familje dhe legjislacionin përkatës. Për me shume qëllimi i punëtorisë ishte për përmasimin e adresimit te rasteve te

Udhëheqësja e sektorit për te Drejtat e Njeriut Barazi Gjinor ka organizuar punëtorinë një ditore te përkrahur nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë lidhur me parandalimin dhe adresimin e dhunës ne familje ne edukim

Kjo punëtori ka pasur qëllim që të ngrisë njohuritë e 25 mësimdhënësve të edukatës qytetare dhe psikologeve te shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Gjakovës, mbi konceptin e dhunës në familje dhe legjislacionin përkatës. Për më shumë, punëtorja ka synuar përmirësimin e adresimit të rasteve të dhunës në familje në shkolla dhe të nxitë bashkëpunimin në mes shkollave dhe Policisë së Kosovës gjatë procesit të raportimit.

Janë mbajtur mbi 20 takime me anëtarët e mekanizimit kundër dhunës ne familje.

Komuna e Gjakovës , komfor strategjisë dhe PLV ka ndërmarr masa parandaluese, (takime informuese mbi dhunën ne baza gjinore) , mbështetëse, dhe masa për ri-integrimin e viktimave te dhunës ne baza gjinore(Mbulimin e pageses te 8 viktimave te dhunës ne

Duke iu referuar te dhënave te Stacionit Policor ne Gjakove , gjate periudhës janar-dhjeto 2024 janë trajtuar 133 raste te dhunës ne baza gjinore.

Një nder pikat gjate takimeve me anëtarët e MKDHF kanë qenë ;

Trajtimi i rasteve emergjente te viktimave te dhunës ne familje.

Prezantimet e të dhënave statistikore ,te arriturat dhe sfidat e MKDHF, si dhe gjendja aktuale lidhur me rastet të dhunës në familje ,etj



Momente te shkëputura nga takimet me anëtarët e mekanizimit kundër dhunës në familje



Janë mbajtur mbi 5 takime me Grupin e Grave Asambleiste të komunës së Gjakovës.



Organizimi i një punëtorie me temën :**"Ngritja e kapaciteteve të zyrtareve/zyrtarëve të komunës për integrimin gjinor dhe vlerësimin e ndikimit gjinor në politikat publike në nivel lokal"** e përkrahur nga zyra e UN Women në Kosovë.

Qëllimi i punëtorisë ishte prezantimi kornizës juridike në lidhje me barazinë gjinore dhe me theks të veçantë në rolin e asamblesë komunale në integrimin e perspektivës gjinore të Kosovës dhe shembuj të praktikave më të mira të qeverisjes së përgjegjshme gjinore para zyrtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës. Në këtë punëtori morën pjesë 10 zyrtar komunal.

Në kuadër të aktiviteteve “ Promovimi i të drejtave të grave dhe fuqizimi i rolit të tyre në trashëgiminë pronësore” edhe për vitin 2024 ka vazhduar UA, Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në Emër të dy bashkëshortëve,

Në bashkëpunim me shoqërinë civile në veçanti me organizatën Femra Aktive e Gjakovës janë mbajtur disa takime në zonat urbane dhe rurale lidhur me të drejtat pronësore dhe Regjistrimin e Pronës në emër të dy Bashkëshortëve.

Numri I pronave të regjistruara në komunë për periudhën Janar – Dhjetor 2024 ka qenë **3200 lëndë**

Numri i pronave të regjistruara në emër të dy apo më shumë personave dhe me gjini të ndryshme, Janar-Qershor 2024, ka qenë **348 lëndë**

Udhëheqësja e sektorit për te drejtat e njeriut – barazi gjinore ne bashkëpunim me Grupi i Grave Asambleiste të Gjakovës, ka organizuar një tryezë ne kuadër te fushatës kundër kancerit te gjirit për sensibilizimin e femrave për këtë sëmundje dhe ne parandalimin e saj, me qëllim te vetëdijesimit te grave për rëndësinë e vizitave dhe kontrollit te tyre ne parandalimin e sëmundjeve kancerogjene ,si dhe arritja me e larte e njohurive për evidentimin e sëmundjeve te gjirit dhe bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse. Si paneliste ne tryeze ishin ; drejtoresha e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, drejtoresha e me Europen Clinic-dok. Aida Kumnova ,nje mbijetuar e kancerit te gjirit dhe udhëheqësja e sektorit për te drejtat e njeriut..

Pjesëmarrëse gjate tryezës ishin qytetaret e komunës se Gjakovës dhe gratë mbijetuarat e kancerit te gjirit.

Ne kuadër te fushatës kundër te kancerit te gjirit ,Udhëheqësja e sektorit për te drejtat e njeriut dhe barazi gjinore ka organizuar një seance psiko-sociale për gratë te prekura nga kanceri i gjirit. Ne këtë aktivitet morën pjesë 25 gra te prekura nga kanceri i gjirit.

Ne kuadër te fushatës kundër kancerit te gjirit ,Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ne bashkëpunim me zyrën për barazi gjinore ka organizuar ligjërata për nder te Muajit te Ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit ne te gjitha Qendrat e mjekësisë familjare ne bashkëpunim me Europen Clinic. Klinike e cila gjate muajit Tetor iu ka ofruar kryerjen e PAP testit pa pagese. Me qellim te sensibilizimit te qytetarëve e ne veçanti te grave për luftimin e kësaj sëmundje mjaft te përhapur ne Kosove dhe ne te gjithë boten. Theksi i këtyre ligjëratave ishte informimi mbi rëndësinë e zhvillimit te hershem te kësaj sëmundje dhe mënyrat e kontrollimit tek gratë.

Me rastin e hapjes së fushatës “Tetori – Muaji i mundësive të barabarta profesionale për personat me aftësi të kufizuar”, Kuvendi Komunal Gjakovë zhvilloj aktivitetin me qëllim te promovimit te kësaj fushate e cila synon ngritjen e vetëdijes tek institucionet komunale dhe tek qytetaret e komunës se Gjakovës lidhur me nevojat specifike te personave me aftësi te kufizuar (PAK).

Udhëheqësja e sektorit për te Drejtat e Njeriut- Barazi Gjinore, ka zhvilluar këtë aktivitet me qëllim të integritimit te PAK-ve në institucionet qeveritare. 25 te rijnë dhe te reja ishin pjese e këtij aktiviteti te cilët u angazhuan në punë një-ditore nëpër sektorët e administratës komunale ne Gjakovë. Rrjedhimisht, komuna e Gjakovës ka realizuar këtë objektivë dhe synon qe edhe me tutje te lehtësoj jetën dhe mundësit të barabartë, pa dallim, edhe për personat me aftësi të kufizuar. Objektivi e këtij projekti është ofrimi i lehtësirave në të gjitha fushat e jetës dhe të punës në mënyrë të barabartë, pa dallim, edhe për personat me aftësi të kufizuar.

Ky aktivitet i Sektorit për te drejtat e njeriut- barazi gjinore është bërë me qëllim të ngritjes së vetëdijes, se edhe PAK mund të japin kontributin e vetë si dhe të integrohen në institucionet qeveritare ashtu edhe në ato private

Me rastin e hapjes se fushatës kundër Trafikimit me qeneje njerëzore ne komunën e Gjakovës janë shpërnda materiale promovues kundër Trafikimit me Njerëz ne te gjitha shkollat e komunës (gjithsej 47 shkolla)duke u dakorduar me DKA-n . Ku mësimdhënësit e lëndës se edukatës qytetare kane ligjëruar për trafikimin e njerëzve, qëllimi ka qene ti përcëllimin informata lidhur me para ndalimin e trafikimit me qenie njerëzore.

Ne përmbyllje te fushatës kundër trafikimit me qeneje njerëzore komuna e Gjakovës në bashkëpunim me MAPL është organizuar hapja e një tende në qendër te qytetit ku janë shpërnda materiale informues(fletëpalosje) me qëllim te informimit te rinjve dhe te rejave mbi parandalimin e trafikimit me qeneje njerëzore.

Hapja e fushatës “16 Dite aktivizim kundër dhunës ne baza gjinore “ në Komunën e Gjakovës këtë vit filloj ne Bibliotekën e Qytetit “ Ibrahim Rugova” . Hapjen e fushatës e bëra unë(udhëheqësja e sektorit per te drejtat e njeriut dhe barazi gjinore), ku pastaj morën fjalën, Drejtoresha e drejtorisë se Shëndetësisë dhe Mire Qenies Sociale, drejtori i Qendrës për Pune Sociale, Komandanti i Stacionit Policor te Gjakovës, Drejtoresha e Shtëpisë se Sigurte; Me pas vazhduam me hapjen e ekspozite ne sallën e bibliotekës , ku u shpalosen vizatimet e nxënësve te shkollave te komunës se Gjakovës.

Në hapje te fushatës me 25 Nëntor, në te gjitha shkollat fillore dhe te mesme te Komunës se Gjakovës, mësimdhënësit ne orën e parë te mësimit të mbajë një ligjëratë për “Dhunën në familje dhe dhunën ne baza gjinore.

Aktivitet ne vazhdim ne kuadër te fushatës 16 Ditë aktivizimi kundër dhunës ne baza gjinore.

Organizimi i një emisioni ne TV dhe radio(Tv- Syri dhe Radio Gjakova), ne kuadër te fushatës 16 ditë aktivizimi kundër dhunës ne baza gjinore.

Takim me Kryetarët e Këshillave Lokale dhe me Anëtarët e MKKDHF-se - informim për funksionimin e MKKDHF.

Takim me Asambleistet e Komunës se Gjakovës dhe Komitetin për Barazi Gjinore – Prezantimi I punës se MKKDHF-se dhe bashkëpunimi në të ardhmen.

Takime derë më derë me qytetarët në rreth 350 familje. Sesione informuese mbi dhunën ndaj grave - organizuar nga OJQ “Roma in Action”.

Ligjëratë me gratë -viktima te dhunës ne familje te strehuara ne strehimoren “Shtëpia e Sigurt”, nga punonjësit shëndetësorë te repartit Psikiatrik ne Gjakove me temën “Shëndeti mendor dhe pasojat”.

Aktivitet nga Medica Kosova ne bashkëpunim me Universitetin “Fehmi Agani”-. Sesion informuese me student

OJQ "Handikos" do të organizojë një sesion informues me punonjësit e shëndetësisë të QKMF-së dhe një sesion informues me mësimdhënësit e disa prej shkollave të komunës së Gjakovës..

Tryeze e rrumbullakët me të gjithë anëtarët e MKKDHF-se dhe bashkëpunëtorë me teme diskutimi.....- organizohet me mbështetjen e Roma In Action.

Lansimi i dokumentarit në TV, radio dhe rrjete sociale -që trajton dhunën në familje, me fokus të veçantë temën e martesave të hershme në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Ky aktivitet, organizohet nga "Roma in Action", do të mbahet më 10 dhjetor, në përmbyllje të fushatës dhe me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut

Sesione informuese në shkollat fillore dhe të mesme të Komunës së Gjakovës -

